

STATUTI I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"S.G.M" Shpk



Sot me date 30.01.2018, Tirane, si themelues me te dhenat e meposhteme:

Z. Stefano Zunino, qytetar italian, i lindur ne Urbe SV, i datelindjes 07.03.1939, rezident ne Itali, me Nr. karte identiteti AT 0367097.

Shoqeria Stellatium Srl, kompani e rregjistruar ne Itali e perfaqesuar nga Z. Stefano Zunino me Nr. karte identiteti AT 0367097, shtetas italian i datelindjes 07.03.1939.

kane vendosur te nenshkuajne Statutin e meposhtem te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar, aktiviteti i se ciles rregullohet nga Legjislacioni shqiptar ne fuqi dhe nga ky Statut.

KREU I
FORMA, EMERTIMI, OBJEKTI, KOHEZGJATJA, SELIA

Neni 1 - Forma

- 1.1 Shoqeria "S.G.M" Shpk (ne vijim "Shoqeria"), krijohet ne formen e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar, dhe veprimtaria e saj rregullohet me ane te ketij Statuti dhe Aktit te Themelimit.
- 1.2 Shoqeria vepron sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi.
- 1.3 Akti i themelimit dhe Statuti jane ne perputhje me legjislacionin shqiptar qe ka karakter te detyrueshem, ndersa çeshtjet qe nuk jane shprehimisht te parashikuara ne to, plotesohen nga legjislacioni shqiptar.

Neni 2 - Emertimi

- 2.1. Emertimi i Shoqerise eshte "S.G.M" Shpk

Neni 3-Objekti i shoqerise

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "S.G.M Shpk" do te zhvilloje aktivitet me objektin e meposhtem:

- Tregtimin e veshjeve dhe aksesoreve ne pergjithesi; tregtimin e te gjithë produkteve te sektorit ushqimor dhe atij joushqimor.
- Import, eksport dhe tregtimin e te mirave materiale dhe jomateriale pjese te aktiviteve te siperpermendura,
- Rekrutimin e kontratave te agjensise dhe te depozitave te te mirave materiale dhe jomateriale tyre per veprimtarite e mesiperme.
- Ofrimi i sherbimeve kolaterale per aktivitetet e mesiperme; marrje/ofrim sherbime perfaqesimi me ose pa depozite te kompanive, shoqerive si dhe institucioneve te çdo lloji, qofshin vendase ose te huaja. Brenda kufijve dhe kushteve te percaktuara me ligj, shoqeria nder te tjera mund te kryeje aktivite tregtare, industriale, aktivitet te pasurive te luajtshme, pasurive te paluajtshme, aktivite financiare, bankare dhe te kreditimit - duke

perfshire edhe ofrimin e garancive reale dhe personale ne favor te vet dhe/ose paleve te treta nese eshte ne interesin social te shoqerise.

- Nese konsiderohet si e nevojshme ose e dobishme per arritjen e objektivit social shoqeria mund te marre pjese ne kompani te tjera italiane ose te huaja, per llogari te vet per qellime investimi.
- Ne kuader te qellimit te investimit te qendrueshem shoqeria mund te marre pjese ne menyre financiare ose operationale, ne te tjera shoqeri " joint venture", shoqeri te perziera (mikse), partneritete te perkohshme apo grupime europiane te interesave ekonomike.

Perjashtohen nga objekti i shoqerise, aktivitetet e rezervuara per ndermjetesit financiare, si dhe cdo aktivitet tjetër, i cili me ligj eshte i rezervuar/percaktuar per tu realizuar nga te tjera shoqeri ne vecanti

Neni 4 - Selia

- 4.1 Selia e shoqerise eshte ne: Rr. "Ibrahim Rrugova", Pallati 17, Hyrja 3, Apartamenti 12, Njesia Administrative Nr.5, Tirane
- 4.2 Transferimi i Selise se shoqerise ne nje vend tjetër do te behet nga Vendimi i Asamblese se Ortakeve.
- 4.3 Asambleja e Ortakeve do te vendose hapjen e filialeve, degeve dhe zyrave perfaqesuese ne qytete te tjera te Shqiperise dhe jashte vendit.

Neni 5 - Kohezgjatja

- 5.1 Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise eshte percaktuar deri me 31/12/2050.
- 5.2 Shoqeria mund te priset perpara ketij afati ose mund te zgjase kohezgjatjen e saj me Vendim te Ortakeve.

KREU II

KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, NDARJA DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE

Neni 6 - Kapitali themeltar

- 6.1 Kapitali themeltar eshte 30,000 (tridhjete mije) leke.
- 6.2 Kapitali themeltar i Shoqerise perbehet nga 2 (dy) kuota, te gjitha te nenshkruara dhe per tu shlyer, me vlere te pergjithshme 30,000 (tridhjete mije) leke.

Neni 7 - Kontributet

- 7.1 Kontributi ne kapitalin e shoqerise eshte ofruar si me poshte:
 - Shoqeria "Stellatium Srl" ofron nje kontribut prej 29,700 (njetete e nente mije e shtateqind) Leke
 - Z. Stefano Zunino, qytetar Italian ofron nje kontribut te barabarte me 300 (treqind) Leke,
- 7.2 Sipas kontributeve te mesiperme :
 - Shoqerise "Stellatium Srl" i korrespondon 1 (nje) kuote e kapitalit te Shoqerise, qe perfaqeson 99% te kapitalit te shoqerise;
 - Z.Zunino Stefano i korrenspondon 1% e kapitalit te shoqerise.



Neni 8 - Rritja e kapitalit themeltar

- 8.1 Kapitali themeltar mund te rritet pa kufi ne çdo moment, nje ose disa here, me vendim te Asamblese se Ortakeve.
- 8.2 Ne rast rritjeje te kapitalit, te gjithë ortaket kane te drejten te nenshkruajne rritjen ne raport me pjeset e kapitalit te zoteruara. Ne rast se disa nga ortaket nuk e ushtrojne kete te drejte, pjeset e tyre mund te nenshkruhen nga ortaket e tjere proporcionalisht me pjeset e kapitalit te zoteruara prej tyre.

Neni 9 - Zvogelimi i kapitalit themeltar

- 9.1 Shoqeria mund te zvogeloje kapitalin themeltar me vendimin e Asamblese se Ortakeve. Ne çdo rast kapitali themeltar nuk mund te zvogelohet nen kufijte e parashikuar nga ligji.
- 9.2 Zvogelimi i kapitalit perballohet nga secili prej ortakeve ne te njejten mase me pjeset e kapitalit te zoteruara prej tyre.

Neni 10 - Transferimi i kuotave

- 10.1 Kuotat jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve.
- 10.2 Nerast transferimi ne çdo lloj forme, si me shperblim ashtu edhe pa shperblim ne kuptimin me te gjere te fjales, duke perfshire ketu edhe dhurimin ne favor te subjekteve te tjere te ndryshem nga ortaket, kuotat duhet me pare t'i ofrohen ne parablerje ortakeve te tjere.
- 10.3 Ne nje rast te tille ortaku qe do te transferoje kuoten e tij duhet te njoftoje ortaket e tjere, me leter rekomande me kthim pergjigje, mbi synimin per shitje, duke percaktuar çmimin, kushtet, modalitetet, emrin e blesesit dhe afatet e transferimit. E drejta e parablerjes duhet t'i referohet te gjitha kuotave te ofruar per shitje.
- 10.4 Ortaket do te kene ne dispozicion 30 (tridhete) dite nga marrja e letres rekomande, per t'i komunikuar ortakut qe transferon kuotat, synimin e tyre per te ushtruar apo jo te drejten e parablerjes. Ne rast se ata nuk pergjigjen ne afatin e caktuar, prezumohet se kane hequr dore nga e drejta e tyre e parablerjes.
- 10.5 Ne rast se oferta pranohet nga disa ortake, kuotat e ofruara nga ortaku qe transferon kuotat, do te ndahen nga ortaket pranues, ne te njejten mase me kuotat qe ata zoterojne, perveç rastit kur ka nje marreveshje te kundert. Ne asnje rast, pranuesi i ofertes nuk mund te ushtroje pjeserisht te drejten e parablerjes.
- 10.6 Ne rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes, kuotat mund t'u transferohen te treteve plotesisht apo pjeserisht.
- 10.7 Kuotat mund te trasferohen per shkak trashegimie *mortis causa*.

KREU III

ASAMBLEJA, ADMINISTRATORET DHE EKSPERTI KONTABEL

Neni 11 - Asambleja e ortakeve dhe kompetencat e saj

- 11.1 Organi vendim-marres i Shoqerise eshte Asambleja e Ortakeve.
- 11.2 Asambleja e Ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per çeshtjet vijuese: ndryshimet e statutit, emerimi e shkarkimi i administratoreve, eksperteve kontabel e



likuidatoreve, zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit, transferimi i kuotave, shperndarja e fitimeve, riorganizimi dhe prishja e shoqerise, miratimi i bilancit dhe per çdo vendim tjetër parashikuar nga ky Statut apo nga legjislacioni perkates.

Neni 12 - E drejta e pjesemarrjes dhe e votes

- 12.1 Çdo ortak ka ta drejte te marre pjese ne Asamble, te paraqese mendimin e tij dhe te jape aq vota sa eshte numri i kuotave qe ai zoteron.
- 12.2 Çdo ortak ka te drejte te perfaqesohet nga nje person tjetër jo-ortak, i pajisur me prokure me shkrim, me anen e se ciles mund te jape voten e tij.
- 12.3 Ortaku nuk mund te leshoje prokura per votim per nje pjese te kapitalit qe zoteron, ne qofte se voton personalisht per pjesen e mbetur.

Neni 13 - Thirrja e Asamblese se Ortakeve, Kuorumi dhe Vendimet

- 13.1 Asambleja e Ortakeve thirret te pakten nje here ne vit, brenda 6 (gjashte) muajve nga mbyllja e vitit financiar per miratimin e bilancit, te raportit te Administratorit, ekspertit kontabel si dhe inventarit.
- 13.2 Asambleja mund te thirret ne çdo moment nga nje prej Administratoreve si dhe prej nje ose disa ortakeve qe perfaqesojne te pakten 5% (pese perqind) te kapitalit themeltar. Asambleja duhet te thirret nepermjet njoftimit me leter rekomande me kthim pergjigje me fax apo telegram qe duhet t'u dergohet ortakeve ne adresen qe rezulton ne Librin e Ortakeve - dhe ekspertit kontabel (nese eshte emeruar), te pakten 8 (tete) dite perpara mbledhjes se Asamblese. Thirrja duhet te permbaje informacion mbi llojin e Asamblese, mbi çeshtjet qe do te trajtohen dhe per te cilat do te merret vendim, mbi vendin, oren dhe daten e thirrjes se pare dhe te dyte.
- 13.3 Asambleja mund te thirret edhe jashte selise se Shoqerise, veç ne Itali ose ne Shqiperi.
- 13.4 Ne rast se Asambleja e Ortakeve nuk mblidhet me thirrjen e pare per mungesen e kuoromit te parashikuar ne piken 13.7 te ketij Statuti, Asambleja e Ortakeve do te thirret brenda 30 (tridhjete) ditesh me te njejtin rend dite.
- 13.5 Mbledhjet e Asamblese mund te mbahen edhe nepermjet telekonferences dhe videokonferences, me kusht qe te gjithë pjesemarrësit te mund te identifikohen dhe t'u lejohet atyre te ndjekin diskutimin dhe te nderhyjne ne momentin e trajtimit te çeshtjeve ne rend te dites; pasi te jene verifikuar keto kerkesa qe duhet te rezultojne ne procesverbalin e mbledhjes, Asambleja konsiderohet e mbajtur ne vendin ku ndodhet Kryetari ne te cilin duhet te ndodhet edhe Sekretari i mbledhjes.
- 13.6 Asambleja do te thirret dhe mbahet rregullisht edhe pa respektimin e formaliteteve te njoftimit, ne rast se jane te pranishem ortakët qe perfaqesojne te tere kapitalin themeltar.
- 13.7 Vendimet e Asamblese se Ortakeve, per te cilat kerkohet nje shumice e thjeshte, jane te vlefshme nese jane te pranishem ortakët me te drejte vote qe zoterojne me shume se 70% (shtatedhjete perqind) te kapitalit themeltar. Vendimet e Asamblese se Ortakeve qe kerkojne nje shumice te cilesuar, jane te vlefshme nese jane te pranishem ortakët me te drejte vote qe zoterojne me shume se 70% (shtatedhjete perqind) te kapitalit themeltar.
- 13.8 Asambleja e Ortakeve vendos me shumice te cilesuar ndryshimet e statutit, zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise, me voten pro te $\frac{3}{4}$ (tre te katertat) e ortakeve te pranishem. Ne te gjitha rastet e tjera, Asambleja e Ortakeve merr vendime me shumice te thjeshte votash te ortakeve te pranishem.
- 13.9 Çdo Asamble drejtohet nga nje ortak ose ndonje person tjetër i caktuar nga vete Asambleja. Per pasqyrimin e vendimit Asambleja emerone nje Sekretar, qe mund te jete edhe jo-



ortak.Vendimet e Asamblese duhet te nenshkruhen nga Kryetari i Asamblese dhe nga Sekretari.

Neni 14 - Administrimi

- 14.1 Shoqeria administrohet nga nje administrator i cili do te qendroje ne detyre deri ne shkarkim apo doreheqje ose per nje periudhe prej 5 vitesh.
- 14.2 Perfaqesimi ligjor i Shoqerise i besohet Administratorit.
- 14.3 Administratori mund te ushtroje te gjitha fuqite konform me sa parashikohet ne nenin 95 te Ligjit n. 9901 te dates 14.04.2008 "Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".
- 14.4 Administratori mund te emeruje perfaqesues te posaçem per veprime apo kategori te caktuara veprimesh.
- 14.5 Adminisitrator i pare i shoqerise emerohet Z. Stefano Zunino, lindur ne Urbe SV, ne date 07.03.1939, qytetar italian, mbajtes i kartes se identitetit nr. AT 0367097.

Neni 15 - Eksperti kontabel i autorizuar

- 15.1 Ne rast se kerkohet nga ligji apo vendoset nga Asambleja e Ortakeve, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabel te Shoqerise mund t'i besohet nje ose disa eksperteve kontabel te autorizuar.
- 15.2 Eksperti kontabel i autorizuar mund te shkarkohet sipas menyres se parashikuar nga legjislacioni ne fuqi.

KREU IV

VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPERNDARJA E FITIMEVE

Neni 16 - Viti financiar dhe bilanci vjetor

- 16.1 Viti financiar fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor te secilit vit.
- 16.2 Viti i pare financiar fillon ne daten e regjistrimit te Shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe perfundon me 31 dhjetor te te njejtit vit.
- 16.3 Bilancet vjetore, inventari, raportet e Administratorit dhe ekspertit kontabel te autorizuar miratohen nga Asambleja me shumicen e kerkuar nga Ligjit n. 9901 te dates 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".
- 16.4 Miratimi i dokumentave qe lidhen me vitin financiar duhet te behet brenda 6 (gjashte) muajve qe nga fundi i vitit financiar.

Neni 17 - Fitimet

- 17.1 Fitimet qe rezultojne nga bilanci vjetor, u shperndahen ortakeve ne proporcion me pjeset e kapitalit themeltar te zoteruara.
- 17.2 Asambleja mund te vendose edhe zbritje te veçanta ne favor te rezervave te jashtezakonshme ose per qellime te tjera apo dhe shtyerjen e shperndarjes se fitimeve, plotesisht ose pjeserisht, per vitet financiare te ardhshme.



KREU V
SHPERNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE

Neni 18 - Prishja

- 18.1 Shoqeria priset me perfundimin e afatit te parashikuar nga Statuti, ose perpara perfundimit ne rastet e parashikuara nga ligji, ose me ane te nje vendimi te Asamblese se Ortakeve, me shumicen e kerkuar per ndryshimet ne statut.
- 18.2 Shoqeria nuk priset ne rast te humbjes se zotesise per te vepruar, vdekjes, ose falimentimit te ortakeve.

Neni 19 - Likuidimi

- 19.1 Ne rast prishje, Shoqeria duhet te likuidohet.
- 19.2 Per te administruar kete procedure, Asambleja emerone nje ose me shume likuidatore, te cilet paraqesin raportet perfundimtare mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetin te Shoqerise, mbi operacionet e likuidimit, dhe mbi kohen e nevojshme per te perfunduar likuidimin.
- 19.3 Me perfundimin e procedures se likuidimit, Asambleja do te vendose mbi bilancin financiar perfundimtar, mbi punen e kryer nga likuiduesi dhe mbi perfundimin e procesit te likuidimit.
- 19.4 Pas pagimit te kreditoreve dhe mbledhjes se krediva, likuidatori do t'i shperndaje te ardhurat perfundimtare te likuidimit ortakeve, ne proporcion me pjeset e kapitalit te zoteruara prej tyre ne kapitalin themeltar.

Neni 20 - Zgjidhja e mosmarreshjeve


- 20.1 Te gjitha mosmarreshjet qe mund te lindin ne lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e ketij statuti dhe aktit te themelimit, si edhe ato qe mund te lindin ne pergjithesi midis ortakeve (pervec atyre personale apo jashte Shoqerise) ose midis nje apo me shume ortakeve dhe Shoqerise, do te zgjidhen ne menyre miqesore dhe do te diskutohen ne menyre te drejtperdrejte ndermjet paleve te interesuara.
- 20.2 Ne rast se nuk arrihet ne nje zgjidhje miqesore te mosmarreshjes, palet mund te bien dakord per zgjidhjen e mosmarreshjes nga nje koleg arbitral i perbere nga tre arbitra.

Neni 21 - Gjuha

- 21.1 Ky Statut eshte hartuar ne 4 (kater) kopje ne gjuhen shqipe.


ORTAKET THEMELUES

Z. Stefano Zunino



"Stellatium Srl"

Perfaqesuesi Ligjor



STELLATIUM s.r.l.

Sede Leg.: Strada Genova, 66
10024 MONCALIERI (TO)
C.F. E P.IVA 03235840042
Numero REA: TO-116217

Notere Majlinda DEMOLLARI

Dhoma e Noterise Tirane

Rr"Vaso Pasha "

Tel Fax ++269948

Nr. 351 Rep

Nr. 310 Kol

Majlinda E. Demollari
Taksa e Pulluar
U. Pasha



VERTETIM NENSHKRIMI

Ne Tirane, sot me date 30.01.2018 (dymije e tetembedhjete), para meje Noteres Publike Majlinda E. Demollari, anetare e Dhomes se Notereve Tirane, u paraqit personalisht STEFANO ZUNINO,i datelindjes 07.03.1939,shtetas italian ,madhor dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i njohur personalisht prej meje,shoqeria "Stellatium Srl" e perfaqesuar nga STEFANO ZUNINO,i datelindjes 07.03.1939,shtetas italian ,madhor dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i njohur personalisht prej meje i cili deklaroi se sa me siper eshte nenshkruar prej tij dhe une noterja Majlinda E. Demollari vertetoj nenshkrimin e tij sipas ligjit.

NOTERE

MAJLINDA E. DEMOLLARI

NOTERE
Majlinda E. Demollari
Krye. K41606030H
Tel: 0682051560